



## Informacione për kujdestarët ligjorë

- Takimi në prezencë
- Dëftesa
- Masat dhe vendimet për karrierën shkollore

Si do të  
informohem për  
fëmijën tim?

Më shumë informacion në dokument:  
Informacion për kujdestarët ligjorë mbi rregulloret e  
vlerësimit dhe vlerësimin e orientuar drejt mbështetjes  
së nxënësve.


## Elementët e vlerësimit gjithëpërfshirës

Nxënësit vlerësohen në mënyrë gjithëpërfshirëse. Në vlerësimin gjithëpërfshirës vlerësohen aftësitë ndërdisiplinore (personale, metodike dhe sociale) po ashtu edhe aftësitë teknike. Në kopshtin e fëmijëve, mund të përfshihen edhe qasje vlerësimi të orientuara drejt zhvillimit.

Aftësitë ndërdisiplinore janë parakusht për tejkalimin e sfidave të ndryshme dhe për të mësuarit në mënyrë të suksesshme e afatgjatë si dhe për zhvillimin personal.

- Si kujdestar ligjor, ju dhe fëmija juaj do të ftoheni për një shqyrtim të statusit të fëmijes një herë për vit shkollor. Fokusi i bisedës është zhvillimi personal i fëmijës suaj.
- Me dëftesën do të merrni një pasqyrë të nivelit aktual të aftësive të fëmijës.
- Masat dhe vendimet për karrierën e shkollës merren në bazë të një vlerësimi të përgjithshëm.

Gjykimi profesional merr parasysh notat nga testet dhe provimet e performancës si dhe vëzhgimet dhe përvojat e mësuesit në lidhje me procesin mësimor.



### Takimi në prezencë

#### Takimi në prezencë

Takimet në Prezencë janë një element i rëndësishëm i mbështetjes gjithëpërfshirëse dhe kryhen në periudhën midis tetorit dhe marsit. Në këto takime marrin pjesë mësuesit, nxënësit dhe kujdestarët ligjorë. Ecuria dhe zhvillimi në lëndët e ndryshme analizohen në bazë të formularit të diskutimit. Duke marrë në konsideratë ecurinë individuale të të nxënësve formulohen qëllimet që duhet të arrijë nxënësi deri në periudhën e ardhshme të vlerësimit. Në këto takime bëhen rekomandime për karrierën e mëtejshme shkollore të nxënësve.

## Masat dhe vendimet për karrierën shkollore

Masat dhe vendimet për karrierën e shkollore merren nga mësuesi mbi bazën e një vlerësimi të përgjithshëm, vendimit profesional. Bëhet fjalë për vendime për masat edukative përmirësuese dhe speciale, si dhe ndryshimin e nivelit të klasës, nivelit të shkollës, klasave dhe profileve. Aftësitë njohëse, performanca në mësim, aftësitë ndërdisiplinore dhe zhvillimi individual shërbejnë si bazë për vendimet e karrierës shkollore.

Vendimet e mundshme që lidhen me karrierën shkollore janë:

- Kalimi nga kopshti në shkollën fillore
- Kalimi në fund të klasës së 6-të
- Përsëritja ose kapërcimi i klasës
- DaZ (mësimi i gjermanishtes si gjuhë e dytë) ose IF (mbështetja integruese)
- Kalimi në një klasë hyrëse, në klasë të vogël ose në një shkollë speciale
- ...

Masat dhe  
vendimet për  
karrierën  
shkollore

Dëftesa

## Dëftesa

Në fund të vitit shkollor, nxënësit dhe kujdestarët e tyre ligjorë marrin një përmbledhje të nivelit të të nxënitorit të arritur në një periudhë të caktuar vlerësimi së bashku me dëftesën. Dëftesa e shkollës fillore, e cila është një formë zyrtare njoftimi, jep informacion për karrierën shkollore nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, përshkruan se sa mirë janë arritur qëllimet, pra aftësitë përkatëse mësimore në vitin ose semestrin e kaluar shkollor me anë të notave për (aftësitë e transferueshme) dhe notave për (aftësitë lëndore). Dëftesa gjithëashtu ofron informacion për mungesat e arsyeshme dhe të paarsyeshme si dhe shërbimet shtesë. Këto shërbime shtesë individuale mund të përfshijnë ndjekjen e HSK (gjuhës dhe kulturës amtare), punë dhe teza në projekte, diploma gjuhësore, ose çertifikata të shkencave kompjuterike.

Në kopësht, prezenta paraqitet në formularin e dëftesës. Niveli i aftësive ndërdisiplinore tregohet në dëftesën e klasës së parë me nota. Niveli i aftësive teknike tregohet në një raport vjetor në ciklin e dytë dhe në një raport semestral në ciklin e tretë, për këtë përdoren numrat nga 1-6 si dhe vlerat e ndërmjetme 5.5, 4.5 etj.

Të gjitha informacionet në lidhje me vlerësimin janë në faqen e internetit të kantonit  
I aksesueshëm:



Redaktoi  
Zyra për Shkollën Fillore dhe Sportin  
Kollegiumstrasse 28, 6431 Schwyz  
[www.sz.ch](http://www.sz.ch)

Ekipi redaktues:  
Bruno Hauser; Leiter ASEB;  
Franziska Lustenberger, ASEB  
Marco Wanner, ASEB

Rishikimi i përmbajtjes:  
Marcel Gross; Leiter ASC  
Rita Marty, LSZ  
Pascal Staub, VSLSZ  
UeliJurt, PHSZ

### **Baza ligjore**

Këto udhëzime bazohen në rregulloret e vlerësimit (SRSZ 613.211), rregulloret e zbatimit për rregulloret e vlerësimit dhe fletushkën mbi vlerësimin në mësimdhënien e orientuar nga kompetenca.

© Qershor 2023